

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6782
E mërkurë, 14 dhjetor 2022
çmimi 0.40 €

Ministrat e BE-së kërkojnë që liberalizimi i vizave për Kosovën të përmbyllet sa më shpejt | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SITUATË E NJËJTË NË VERI | FAQE 4-5

DITA E KATËRT E BARRIKADAVE NË VERI



Për të katërtën ditë me radhë në veri të Kosovës disa rrugë vazhdojnë të jenë të bllokuara. Kamionë të rëndë dhe mjete të tjera vazhdojnë ta bllokojnë

rrugën në fshatin Rudar në Zvečan. Që nga 10 dhjetori serbët lokalë kanë ngritur barrikada në shenjë pakënaqësie pas arrestimit të një ish-pjesëtari serb të

Policisë së Kosovës, për të cilin autoritetet në Kosovë thonë se ka organizuar sulme ndaj zyrave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri

AKTUALE




BRITANIA SANKSIONON USHTARAKË RUSË DHE KOMPANI TË DRONËVE IRANIANË | F. 2

PLANI FRANKO-GJERMAN, "BAZË E MIRË" PËR BISEDIME TË MËTEJSHME | F. 5

BEKIM JASHARI: JEMI TË GATSHËM SI SHTET, POR EDHE SI SHOQËRI T'I DALIM ZOT VENDIT TONË | F. 2


EKONOMI



MBI 2.8 MILIONË EURO NDAHEN PËR KOMPENSIMIN E DËMEVE NË BUJQËSI | F. 8

AMBASADORI AMERIKAN: SEKTORI PRIVAT LUAN ROL TË RËNDËSISHËM NË FUQIZIMIN EKONOMIK | F. 8

SPORT



MAROKU KËRKON EDHE NJË TJETËR BEFASI NË BOTËTOR | F. 10

KOSOVA KËTË JAVË DO TA DORËZOHË APLIKIMIN PËR ANËTARËSIM NË BE | FAQE 3

AKADEMIK QOSJA PËRKRAH INICIATIVËN QË LULËKUQJA ME KATËR PETALE TË JETË SIMBOL I GJENOCIDIT NË KOSOVË | FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania sanksionon ushtarakë rusë dhe kompani të dronëve iraniane

LONDËR, 13 DHJETOR - Mbretëria e Bashkuar ka njoftuar për sanksione të reja që shënjestrojnë komandantë të lartë rusë dhe kompani të zyrarë iraniane të përfshirë në prodhimin apo furnizimin e Moskës me dronë që po përdoren në sulmet kundër infrastrukturës energjetike të Ukrainës.

Qeveria britanike tha se 12 komandantë të lartë të forcave ruse, përfshirë edhe njësitë ndaj qyteteve ukrainase, janë sanksionuar. Në listën e sanksioneve është edhe gjeneralmajor Robert Baranov, i

identifikuar nga grupi hulmues "Bellingcat" si komandant i një njësie përgjegjëse për sulme ajrore.

Tre iraniane dhe një kompani iraniane, po ashtu, janë sanksionuar dhe janë subjekt i ngrirjes së aseteve, ndalimit të udhëtimeve dhe të transportit. "Regjimi iranian është jashtëzakonisht i izoluar në mes të thirrjeve për ndryshim nga populli i vet dhe po arrin marrëveshje me presidentin rus Vladimir Putin në përpjekje të dëshpëruara për të mbijetuar", tha sekretari i Jashtëm britanik, James Cleverly, në një deklaratë. "Putini dëshiron ta thyejë



shpirtin e Ukrainës, por nuk do t'ia dalë. Ukraina do të fitojë dhe Ukraina do të rindërtohet", shtoi ai.

Cleverly iu referua trazirave në

Iran për shkak të vdekjes së një gruaje të re në kohën kur ishte në paraburgim, nën pretendimet se kishte shkelur rregullat e veshjes së hixhabit, apo shamisë së

kokës.

Zemërimi për vdekjen e Mahsa Amini, 22 vjeçe, ka nxitur protesta mbarëkombëtare, që paraqesin sfidën kryesore për udhëheqjen islamike, qëkur ajo erdhi në pushtet pas Revolucionit Islamik të vitit 1979. Në deklaratë u tha se në paketën e re të sanksioneve janë shënjestruar edhe persona që ndihmojnë në prodhimin e dronëve, përfshirë edhe bashkëthemeluesin dhe drejtorin menaxhues të MADO, kompanisë përgjegjëse për prodhimin e motorëve për dronë, që Rusia po i përdor në Ukrainë.

BE-ja arrin marrëveshje me Hungarinë për 18 miliardë euro ndihmë për Ukrainën



Bruksel, 13 dhjetor - Bashkimi Evropian ka arritur marrëveshje me Hungarinë për të zhblokuar 18 miliardë euro ndihmë financiare për Ukrainën në këmbim të reduktimit të fondeve të ngrira nga BE-ja për Budapestin.

Hungaria ka bllokuar nisma kyçe të BE-së, përfshirë edhe mbështetjen vitale për Kievin dhe një plan për taksën minimale për korporatat. Këto bllokada janë bërë me qëllim që t'i bëhet presion bllokut që t'i zhblokojë fondet për Budapestin. Muajin e kaluar Brukseli

rekomandoi ngrirjen e 7.5 miliardë eurove fonde për Budapestin, duke u thirrur në shqetësimet lidhur me korrupsionin.

Bashkimi Evropian ka bllokuar 5.8 miliardë euro fonde për rimëkëmbjen nga pandemia për shkak të përkeqësimit të demokracisë në Hungari.

Ambasadorët arritën një kompromis me Budapestin, pasi ky i fundit dha miratimin për ndihmën për Ukrainën dhe për vendosjen e një taksë minimale prej 15-përqindësh gjatë vitit të

ardhshëm.

Në këmbim të kësaj, shtetet evropiane janë pajtuar që t'i shkurtojnë fondet e ngrira prej 6.3 miliardë eurosh.

Kjo marrëveshje pritet që të konfirmohet zyrtarisht më vonë gjatë kësaj jave.

Kompromisi nënkupton që kryeministri hungarez Viktor Orban do ta mbështesë paketën e BE-së për Ukrainën në mënyrë që Kievi të përballet më mirë me pushtimin rus që ka nisur në fund të shkurtit.

Von der Leyen: Akuzat për korrupsion në BE janë "shumë serioze"



BRUKSEL, 13 DHJETOR - Pretendimet se Katari u ka dhënë rryshfet zyrtarëve të Bashkimit Evropian në përpjekje për ta fituar ndikim përbëjnë "shqetësim të madh", tha presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen.

Ajo tha se akuzat janë "shumë shqetësuese" dhe "shumë serioze" dhe bëri thirrje për krijimin e një organi të ri të etikës në BE.

Më 10 dhjetor policia belge arrestoi katër persona, mes tyre edhe zëvendës-presidenten e Parlamentit Evropian, Eva Kaili, lidhur me disa hetime për korrupsion dhe pastrim parash. Katari i ka mohuar këto pretendime.

Policia belge sekuestroi të premtën rreth 600 mijë euro pas bastisjes në 16 lokacione në Bruksel. Po ashtu, janë sekuestruar edhe kompjuterë

dhe disa telefona. Ligjbërësja greke, Eva Kaili, njëra nga 14 zëvendës-presidentët e Parlamentit Evropian, u mor në pyetje ditën e arrestimit.

Pas kësaj, Kaili është përjashtuar nga partia e saj në Greqi, Lëvizja Panhelenike Socialiste (PASOK). Edhe grupi i qendrës së majtë të Socialistëve dhe Demokratëve në Parlamentin Evropian e suspendoi

Kailin menjëherë.

Prokurorët në Greqi thanë, gjithashtu, se i kanë ngrirë të gjitha asetet e saj.

Sipas raportimeve, ky hetim mund të përfaqësojë një nga skandalet më të mëdha të korrupsionit në historinë e Parlamentit Evropian.

Von der Leyen tha se besimi në institucionet evropiane kërkon standardet më të larta etike.

Themeluesi i FTX arrestohet në Bahama në bazë të akuzave amerikane

NJU-JORK, 13 DHJETOR - Policia në Bahama ka arrestuar Sam Bankman-Fried, themeluesin e kompanisë për këmbimin e kriptovalutave FTX, tha prokurori i përgjithshëm i këtij shteti. Ai pritet që të dalë të martën para një gjykate në kryeqytetin e këtij shteti të Karaibeve, Nasau.

Policia tha se Bankman-Fried u arrestua për "shkelje financiare" kundër ligjeve në Shtetet e Bashkuara dhe Bahama. Muajin e kaluar FTX shpalli

falimentimin në ShBA, duke pamundësuar që shumë përdorues të kësaj kompanie t'i tërheqin fondet e tyre.

Sipas një dosjeje gjyqësore të paraqitur në gjykatë muajin e kaluar, kompania FTX u detyrohej 50 kreditorëve të saj më të mëdhenj afër 3.1 miliardë dollarë.

Është e paqartë se si personat që kanë fonde në këtë kompani do të mund t'i marrin ato në fund të procedurave të falimentimit. Megjithatë,

shumë ekspertë kanë paralajmëruar se kreditorët do të mund të marrin një pjesë shumë të vogël të shumës së depozituar.

FTX u ka lejuar klientëve që të këmbenin para normale për kriptovaluta, sikurse Bitcoin. Bankman-Fried më herët është parë si një version i ri i investitorit legjendar amerikan Warren Buffett dhe deri në fund të tetorit ai kishte pasuri neto më shumë se 15 miliardë dollarë.



Ministrat e BE-së kërkojnë që liberalizimi i vizave për Kosovën të përmbillet sa më shpejt

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

BRUKSEL, 13 DHJETOR - Procesi i zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe situata në vendet e përfshira në këtë proces, përfshirë ato të Ballkanit Perëndimor, janë temat kryesore të takimit të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së që mbahet të martën në Bruksel. Në këtë takim ministrat e bllokut kanë miratuar disa konkluzë për përparimin e vendeve në procesin e zgjerimit.

Sipas tekstit, ministrat kanë përshëndetur përparimin që ka bërë Kosova në procesin e reformave, në forcimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit, si dhe në luftën kundër korrupsionit, ndërsa kanë kërkuar nga vendi që t'i vazhdojë përpjekjet

për luftë kundër krimit të organizuar.

Kosovës i është shprehur, po ashtu, mirënjohje për mbështetjen e qëndrimeve të BE-së ndaj agresionit të Rusisë në Ukrainë.

Në konkluzë shprehet mbështetja edhe për liberalizimin e vizave për Kosovën si dhe pritja që çështja të përmbillet sa më shpejt.

Nga Kosova, sikur edhe nga Serbia, kërkohet që t'i shtojnë përpjekjet në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me, siç thuhet, "besim të mirë dhe frymë të kompromisit", për të arritur një marrëveshje ligjërshite obliguese.

Kërkohet që të dyja palët, pa vonesa, t'i respektojnë në tërësi të gjitha obligimet nga dialogu dhe të përmbahen nga veprimet apo deklaratat që nxisin tensione.

Në takimin e së martës ministrat e BE-së kanë arritur pajtim për t'i dhënë Bosnjë-Hercegovinës statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE.

Dhënia e statusit të kandidatit shoqërohet me kërkesat për Bosnjë-Hercegovinën që të ndërmarrë hapa për forcimin e ligjit, luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe menaxhimit të migracionit dhe të drejtave themelore.

BE-ja në këtë takim ka shprehur zhgënjim me Serbinë për ecjen prapa që ka bërë në përshtatjen e qëndrimeve të saj me ato të BE-së sa iu përket çështjeve të politikës së jashtme dhe sigurisë.

"Këshilli i BE-së shpreh keqardhje të thellë për ecjen prapa të Serbisë në përshtatje me politikën e përbashkët të jashtme dhe të

sigurisë së BE-së, në veçanti kur është fjala për sanksionet ndaj Rusisë dhe Bjellorusisë, si dhe veprimet e Serbisë në fushën e politikës së jashtme që shkojnë kundër qasjes së përbashkët të BE-së", thuhet në konkluzë.

Në to, po ashtu, shprehet "pritja e madhe" e BE-së që Serbia t'i përmbushë obligimet që ka marrë përsipër në kuadër të kornizës negociuese me BE-në dhe ta forcojë përshtatjen e saj me politikën e jashtme të BE-së dhe atë të sigurisë. Serbia është vendi i vetëm në Ballkan që nuk i ka vënë sanksione Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës.

Ministrat e BE-së kanë mirëpritur faktin që Qeveria e re e Serbisë e ka bërë integrimin në BE qëllim të saj strategjik, por kanë kërkuar që kjo të ndiqet me veprime konkrete.

Me konkluzat që janë miratuar, mirëpritet edhe nisja e negociatave të anëtarësimit mes BE-së dhe Shqipërisë si dhe mes BE-së dhe Maqedonisë së Veriut.

Në përgjithësi, vendeve të rajonit u është kërkuar që të angazhohen edhe më shumë në bashkëpunimin rajonal, forcimin e fqinjësisë së mirë dhe pajtimit.

Nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë nisur negociatat për anëtarësim në BE.

Derisa Bosnjë-Hercegovina pritet ta marrë statusin e vendit kandidat, Kosova pritet të aplikojë këtë javë për anëtarësim në bllokun evropian. Nga aplikimi për anëtarësim deri te marrja e statusit të vendit kandidat mund të kalojnë disa vjet kohë.



Kosova këtë javë do ta dorëzojë aplikimin për anëtarësim në BE

EPOKA
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se gjatë kësaj jave autoritetet do ta dorëzojnë aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian. "Siç e dini, ne jemi vendi i fundit në Ballkanin Perëndimor që po aplikojmë për Bashkimin Evropian edhe pse jemi vendi i parë në këtë rajon për sundimin e ligjit, lirisë dhe demokracisë", ka deklaruar Kurti gjatë mbledhjes së qeverisë të mbajtur më 13 dhjetor. Sipas tij, ka ardhur koha që statusi potencial kandidat, "që na është njohur shumë kohë më parë, ta kthejmë zyrtarisht në status kandidat, duke kaluar në një fazë të re të marrëdhënieve me Bashkimin Evropian". "E kjo është në përputhje me aspiratat e qytetarëve tanë, të cilët besojnë thellë se e ardhmja jonë është brenda Bashkimit Evropian krahas

shteteve demokratike, me të cilët ndajmë vlerat e përbashkëta të lirisë, demokracisë, barazisë e të sundimit të ligjit. Krahasuar me shtetet e rajonit në kohën kur ato kanë aplikuar, Kosova është më e përgatitura; me legjislacion të avancuar e të harmonizuar me Bashkimin Evropian; me institucione të qëndrueshme e me kapacitete të plota për t'u përgjigjur në pyetësonin e Bashkimit Evropian; dhe me indikatorët më të mirë të sundimit të ligjit në rajon", ka thekuar Kurti. Kosova deri më tani ka vetëm një marrëveshje kontraktuale me BE-në, përkatësisht Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit.

Nga 27 shtetet anëtare të bllokut, pesë prej tyre ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Shtetet mosnjohëse janë: Spanja, Rumania, Qiproja, Greqia dhe Sllovakia. Nga shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, Serbia dhe Mali i Zi janë dy shtetet që kanë



bërë më shumë përparim drejt anëtarësimit në bllok, pasi deri më tani kanë hapur disa kapituj në bisedimet për anëtarësim.

Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria gjatë këtij viti nisën procesin e bisedimeve, ndërsaq Bosnjë-Hercegovina këtë javë pritet ta

marrë statusin e vendit kandidat. Kosova, po ashtu, është shteti i vetëm që nuk ka liberalizim të vizave me BE-në.



SITUATË E NJËJTË NË VERI

Dita e katërt e barrikadave në veri

Për të katërtën ditë me radhë në veri të Kosovës disa rrugë vazhdojnë të jenë të bllokuara. Kamionë të rëndë dhe mjete të tjera vazhdojnë ta bllokojnë rrugën në fshatin Rudar në Zveçan. Që nga 10 dhjetori serbët lokalë kanë ngritur barrikada në shenjë pakënaqësie pas arrestimit të një ish-pjesëtari serb të Policisë së Kosovës, që autoritetet në Kosovë thonë se ka organizuar sulme ndaj zyrave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 13 dhjetor - Situata e sigurisë në veri të vendit edhe të martën ka vazhduar të jetë e njëjtë që nga vendosja e barrikadave nga grupet kriminale, po ashtu edhe dy pikat kufitare, Jarinjë dhe Bërnjak, vazhdojnë të jenë të mbyllura tanimë për arsye të njohura, pasi që grupet kriminale po pengojnë lirinë e lëvizjes së qytetarëve dhe qarkullimit të mallrave. Policia e Kosovës ka njoftuar se, pavarësisht prej akteve kriminale dhe sulmeve të raportuara ndaj personelit të sigurisë, personelit monitorues ndërkombëtar dhe medieve, Policia e Kosovës vazhdon të mbetet vigjilente dhe e angazhuar në nivelin dhe moralin më të lartë të kryerjes së detyrave kushtetuese dhe ligjore, në interes të sigurisë së

përgjithshme. “Policia e Kosovës, në kuadër të vlerësimeve dhe planifikimeve operacionale, me kohë ndërmerr masat e sigurisë, masat e nevojshme mbështetëse dhe logjistike, përfshirë veshmbathjen dhe ushqimin për personelin e saj në detyrë. Ashtu siç kemi theksuar edhe më parë, Policia e Kosovës do të vazhdojë të angazhohet për ofrim të sigurisë ndaj të gjithë qytetarëve pa dallime, sjelljen para organeve të drejtësisë së personave të dyshuar si dhe ruajtjen e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës”, ka njoftuar Policia e Kosovës. Policia ka theksuar se punën e saj e bazon në vlerat e saj si profesionalizmi, përgjegjësia dhe integriteti, në kuadër të të cilave ofron siguri dhe i trajton të gjithë qytetarët pa dallime andaj, sipas policisë, spekulimet e vazhdueshme nga mediet, kryesisht serbe, se gjoja zyrtarët

policorë në veri të vendit kanë sjellje jo të mira, të vrazhda dhe jomiqësore ndaj komunitetit serb, nuk qëndrojnë dhe janë të pavërteta. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë kërkuar që të largohen barrikadat dhe kanë dënuar sulmet ndaj Policisë së Kosovës dhe EULEX-it që kanë ndodhur ditët e fundit.

Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka njoftuar se mënyra e vetme për arritjen e paqes së qëndrueshme midis Prishtinës dhe Beogradit është që palët t'i

zgjidhin çështjet e tyre “përmes dialogut dhe të arrijnë një zgjidhje që respekton të drejtat e të gjitha komuniteteve”. “Është e rëndësishme të shmanget çdo përshkallëzim i ri dhe që çështjet të zgjidhen në mënyrë paqësore, pasi dhuna nuk ka vend në rajon. KFOR-u vazhdon të jetë jashtëzakonisht vigjilent dhe plotësisht i aftë ta përmbushë mandatin e tij që derivon nga Kombet e Bashkuara”, u tha në njoftimin e këtij misioni të NATO-s.

Tensionet në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe,

janë rritur që nga 6 dhjetori, teksa janë regjistruar disa incidente të armatosura.

Më 10 dhjetor serbët lokalë ngritën barrikada në veri në shenjë pakënaqësie për arrestimin e ish-pjesëtarit serb të Policisë së Kosovës, Dejan Pantiq.

Gjykata Themelore në Prishtinë njoftoi më 12 dhjetor se Pantiqi i është caktuar masa e paraburgimit prej një muaji. Ai dyshohet për “kryerjen e veprës penale terroriste”.

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka deklaruar se Pantiq “ka organizuar sulmin terrorist” ndaj zyrave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri të Kosovës më 6 dhjetor, kur “janë sulmuar zyrtarë të KQZ-së dhe zyrtarë policorë”.

Teksa Policia e Kosovës ka rritur praninë në veri, Serbia ka paralajmëruar se më 15 dhjetor do t'i drejtohet KFOR-it me kërkesë që të vendosë deri në 1 000 trupa policore dhe ushtarake në Kosovë.

Serbi ka theksuar se ka të drejtë të vendosë trupa në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Paralajmërimet për dërgimin e trupave, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka parë si “kërcënim me agresion” nga Beogradi, ndërkaq presidentja

Haradinaj takon Escobarin: Angazhimi serioz i ShBA-së do të na kthejë te marrëveshja finale për njohje Kosovë - Serbi

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, është takuar të martën me të dërguarin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin, Gabriel Escobar dhe ambasadorin amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier. “Sapo përfundova takimin me z. Escobar dhe ambasadorin Hovenier. Mund t’ju them se janë mjaft të fokusuar në zhvillimet në vend, posaçërisht në veri, me kërkesën

eksplicite që të ulen tensionet, të hiqen barrikadat dhe të kthehet normaliteti në atë pjesë të vendit”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Ai ka thënë se beson se ky angazhim serioz i ShBA-së do ta shpëtojë situatën dhe do të na kthejë te marrëveshja finale për njohje Kosovë - Serbi. “Në emër të AAK-së shpreha falënderimin për ndihmën jetike që po jep ShBA-ja”, ka shkruar Haradinaj.

Plani franko-gjerman, “bazë e mirë” për bisedime të mëtejshme

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Propozimi i Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë është një “bazë e mirë” për bisedime të mëtejshme drejt këtij qëllimi, thonë nga Qeveria e Kosovës. “Kemi dhënë komentet dhe vërejtjet tona, si dhe kemi shprehur gatishmërinë dhe vullnetin për intensifikimin e diskutimeve mbi këtë propozim”, thotë zëdhënësi Përparim Kryeziu për Radion Evropa e Lirë.

Ai nuk jep detaje se çfarë vërejtjesh ose komentesh ka dhënë Qeveria e Kosovës.

Propozimi i BE-së, i njohur edhe si plani franko-gjerman, parasheh të drejta të barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektim të integritetit territorial, paprekshmëri të kufijve, njohje të simboleve shtetërore dhe një aranzhim të veçantë për komunitetin serb në Kosovë.

Në tekstin e propozimit, që siguroi dhe publikoi REL-i një ditë më parë, nuk përmendet njohja e ndërsjellë mes Kosovës dhe Serbisë apo anëtarësimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara - gjëra në të cilat insistojnë publikisht zyrtarët kosovarë.

Një version i këtij propozimi u është dorëzuar tashmë të dyja vendeve.

Shefi i diplomacisë evropiane, Josep Borrell, konfirmoi të hënën se ai u është dërguar edhe ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve anëtare të BE-së. “Kemi shumë mbështetje [për planin]. Ky nuk është më vetëm plani im, por plani i 27 vendeve anëtare të BE-së”, tha Borrell.

Në vazhdim të tensioneve në veri



të Kosovës, shtoi ai, të gjithë ministrat ranë dakord se plani duhet paraqitur si çështje urgjente.

Disa përfaqësues të partive opozitare në Kosovë ndajnë, po ashtu, mendimin se propozimi i BE-së, edhe si i tillë, ofron një bazë të pranueshme për bisedime të mëtejshme me Serbinë. “[Me këtë propozim] marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë rregullohen në bazë të kapitujve të Kartës së OKB-së për marrëdhëniet mes shteteve”, thotë kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, për “Radion Evropa e Lirë”. “Unë besoj se baza është e qëndrueshme dhe kjo marrëveshje [propozim] është e

qëndrueshme, dhe [në fund] e zgjidh çështjen e mbetur pezull - pra të njohjes së ndërsjellë Kosovë - Serbi. Nuk shoh se do të duhet prapë në të ardhmen të bisedohet për njohjen e ndërsjellë për shkak se [ky propozim] e zgjidh një e marrëdhënieve Kosovë - Serbi”, thotë Haradinaj.

Nga partia tjetër opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës, nënkryetari Lutfi Haziri thotë se kjo parti nuk ka ende qëndrim të prerë për propozimin e BE-së. “Ne, parimisht, dialogut i kemi dhënë mbështetje, por konsensusi për dokument të tillë nuk është arritur. Ende nuk kemi thënë po, apo nuk e kemi refuzuar një dokument i cili nuk

na është prezantuar dhe nuk është kërkuar nga ne që t’i japim mbështetje”, thotë Haziri për Radion Evropa e Lirë.

Kosova dhe Serbia, me ndërmjetësimin e BE-së dhe mbështetjen e ShBA-së, janë në negociatë për normalizimin e marrëdhënieve qysh në vitin 2011. Ato kanë arritur dhjetëra marrëveshje, por zbatimi i shumicës së tyre në terren ka ngecur.

Në Kosovë thonë se dialogu duhet të përfundojë me njohje të ndërsjellë, ndërsa në Serbi insistojnë në zgjidhje kompromisi, por pa specifikuar shumë se çka nënkuptojnë me të.

Njohësi i rrethanave politike në Kosovë, Rrahman Paçarizi,

profesor në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, thotë se propozimi i BE-së duhet pranuar vetëm nëse negociatat rreth tij çojnë përfundimisht në njohje të ndërsjellë midis Kosovës dhe Serbisë. “Planim si i tillë, sikur të ishte plan final, nuk do të duhej të pranohej nga Kosova, sepse nuk siguron as njohjen e ndërsjellë dhe, rrjedhimisht, nuk siguron as paqe afatgjatë”, thotë Paçarizi.

Qysh në fund të verës në opinion kanë qarkulluar informacione për ekzistencën e një propozimi të tillë por, deri së voni, ato nuk janë konfirmuar nga zyrtarët e BE-së.

Javën e kaluar Borrelli konfirmoi se Kosova dhe Serbia kanë marrë tashmë një version të planit.

Në dokumentin që ka siguruar REL nënvizohet se Kosova dhe Serbia do të kenë si pikënisje qëllimin dhe parimet e vendosura në Kartën e Kombeve të Bashkuara,

përkatesisht respektimin e pavarësisë, autonomisë, integritetit territorial dhe të së drejtës për vetëvendosje, si dhe ruajtjen e të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimit.

Sipas propozimit, palët do të zhvillojnë marrëdhënie të mira fqinjësore mes vete, duke u bazuar në të drejtat e barabarta si dhe do t’i njihnin simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë pasaportat, targat e veturave, diplomat dhe vulat doganore.

Të gjitha mospajtimet, sipas këtij propozimi, Kosova dhe Serbia do t’i zgjidhnin me mjete paqësore, duke u përmbajtur nga kërcënimet apo përdorimi i forcës. Zyrtarët në Serbi kanë thënë më herët se propozimi nuk është i favorshëm për ta.

Vjosa Osmani ka thënë se territorin e Kosovës nuk do të ketë më kurrë policë dhe ushtarë të Serbisë.

I dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka ardhur për vizitë në Kosovë pas zhvillimeve në veri. Gjatë takimit me presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti është theksuar nevoja e menjëhershme e barrikadave në veri.

Stradner: Rusia me strategji të përshkallëzimit të konfliktit Kosovë - Serbi

Situata në veri të Kosovës, për dallim nga herët e tjera, është më serioze dhe mund të përshkallëzohet për shkak të provokimeve shtesë si nga Beogradi ashtu edhe nga ndikimi rus. Kështu thotë Ivana Stradner, bashkëpunëtoresh shkencore në Fondacionin për Mbrojtjen e Demokracisë në Uashington.

Në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, ajo thotë se

NATO-ja duhet ta përdorë retorikën që do t’ia bëjë të ditur Serbisë dhe Rusisë se “nuk është lodër”. “Rusisë, për ta destabilizuar Perëndimin, nuk i duhet që t’i shtyjë tanket në Uashington ose Bruksel, por i mjafton që të krijojë vatra të reja, në mënyrë që pesha e përqendrimit të zhvendoset plotësisht në veprimet e tjera. Dhe, këtu nuk bëhet fjalë vetëm për Kosovën”, thotë Stradner. Siç thekson ajo, “Rusisë i konvenon konflikti në Ballkan” dhe aty po zhvillon luftë hibride.

Stradner thotë se Rusia kurrë nuk ka investuar vetëm në një parti ose në një njeri dhe ngjashëm ka ndodhur edhe në Serbi. “Ajo ndikon në pushtetin aktual, në SNS-në [Partinë Progresive Serbe të Aleksandër Vuçiqit] dhe, gjithashtu, në opozitë, e cila mjaft shpesh i shpreh qartë qëndrimet e saj ruse”.

Përshkallëzimi i konfliktit, sipas saj, është një nga strategjitë ushtarake të Rusisë, në mënyrë që veten ta vendosë si



ndërmjetësuese. Kjo po ndodh edhe në rastin e Kosovës, vlerëson Stradner. “Rusia, si ndërmjetësuese, nuk do të jetë e pranueshme për Kosovën. Por, ajo dëshiron që të vendoset si

ndërmjetësuese, që së bashku me Amerikën dhe Bashkimin Evropian, të provojë ta zgjidhë këtë konflikt, gjë që sigurisht se nuk do të ndodhë”.

Ajo thekson se i ashtuquajtur

plan franko-gjerman për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi është i vështirë për Serbinë dhe presidentin serb, Aleksandër Vuçiq, nuk do ta pranohet.

Kryetari i Gjilanit paraqet raportin njëvjeçar të punës

GJILAN, 13 DHJETOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka paraqitur para qytetarëve raportin njëvjeçar të punës, i bazuar në tri shtylla: ndryshim, ndershmëri e profesionalizëm, në të cilin ka marrë pjesë edhe kryeministri Albin Kurti.

Kryetari Hyseni, pasi falënderoi kryeministrin Kurti për praninë, ka thënë se për vetëm një vit qeverisje ua kanë kthyer komunën qytetarëve e janë angazhuar me përpunim, modesti e përkushtim. “Modeli ynë i qeverisjes, kryeministri Kurti, nderoi Gjilanin dhe punën tonë me prezencën e tij në Gjilan. Po ashtu, me qindra qytetarë ishin prezent në raportimin tonë për punën 1 vjeçare. Nga 26 milionë euro obligime, për vetëm 11 muaj, kemi paguar mbi 7 milionë. Planifikimet e të hyrave i kemi tejkaluar për qindra mijëra euro, ndërsa investimet janë milionëshe. Me dhjetëra projekte e kosto milionëshe, po e

përmbysim vitin pa asnjë cent obligim”, ka thënë kryetari Hyseni.

Kryeministri Kurti ka thënë se Gjilani sot ka një kryetar që është model i qeverisjes. “Gjilani sot ka një kryetar që është model i qeverisjes. Nga kryetari Hyseni në nivel lokal prisni qeverisje të mirë, shërbime më të mira komunale dhe projekte zhvillimore për të gjithë. Nga ne në nivel qendror prisni politika të mira, menaxhim të mirë të parasë publike, luftim të krimit e korrupsionit, reforma shumë sektoriale, zhvillim ekonomik, përfaqësim të dinjitetshëm e drejtësi gjithandej”, ka thënë Kurti.

Ndërkohë, kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, ka thënë se gjatë kësaj kohe janë përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve dhe rend e rregull brenda institucioneve. “Përfshirje në vendimmarrje e planifikim. Transparent e llogaridhënës”, ka theksuar ai, duke shtuar se Gjilani, nga mungesa e vëmendjes



institucionale qendrore, po kthehet në kryeqendër për investime. “Buxheti i Komunës sonë për 2023 do të jetë rreth 33 milionë, pra 12 për qind më

shumë se në 2022, ndërsa investimet kapitale nga buxheti shtetëror kapin shifrën e afro 47 milionë eurosh. 2023 do të jetë viti i dytë i qeverisjes dhe i pari me

planifikim nga ne. Ndryshime të mëdha na presin. Projekte edhe më të mëdha në horizont. Mirënjohës për besimin tuaj”, është shprehur Hyseni.

Kryetari i Malishevës nënshkruan marrëveshje për hapjen e puseve për ujë të pijshëm për familjet në nevojë



MALISHEVË, 13 DHJETOR - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka pritur në takim përfaqësuesin e organizatës “Qatar Charity”, Gëzim Syla, me të cilin kanë diskutuar për një nismë të bashkëpunimit në mes të komunës së Malishevës dhe organizatës “Qatar Charity” me seli në Kosovë.

Kryetari Kastrati u shpreh tejet mirënjohës ndaj organizatës në fjalë, me të cilën tashmë veç ka filluar një bashkëpunim konkret

përmes firmosjes së një memorandumit të bashkëpunimit, ku parashihet hapja e nëntë puseve për ujë të pijshëm për familjet në kushte të rënda ekonomike në territorin e Malishevës.

Kastrati ka thënë se ky memorandum po i hap rrugë thellimit edhe më tej të bashkëpunimit me organizatën “Qatar Charity”, duke theksuar se shumë shpejt ky bashkëpunim do të zgjerohet edhe në disa fusha të tjera si në shëndetësi dhe bujqësi.



Lladrovci konfirmon themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale të Pastrimit

DRENAS, 13 DHJETOR - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me homologët e komunave të rajonit të Prishtinës, kanë nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit për menaxhimin e integruar të mbeturinave. Ky memorandum do të shërbejë si pikë hyrëse për hartimin e

Planit të Integruar Ndërkomunal për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Marrëveshjen për Bashkëpunim Ndërkomunal në sektorin e menaxhimit të integruar të mbeturinave. “Jemi në fazën përfundimtare të themelimit të Ndërmarrjes Publike Lokale, me çka do ta ndryshojmë njëherë e

përgjithmonë gjendjen që lidhet me grumbullimin e mbeturinave dhe ruajtjen e ambientit si parakusht për cilësinë e jetës sonë”, ka thënë kryetari Lladrovci. Kjo nismë ishte e domosdoshme pas dështimit në menaxhimin e mbeturinave nga kompania regionale “Pastrimi”.

Vazhdon aksioni për parandalimin qarkullimit të taksive ilegale në kryeqytet

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Drejtoria e Inspeksionit në komunën e Prishtinës ka vazhduar

aksionin për parandalimin qarkullimit të taksive ilegale. Sipas njoftimit të kësaj

drejtorie, taksitë ilegale, duke mos respektuar rregullat e trafikut, po paraqesin problem

për mbarëvajtjen e komunikacionit kudo në kryeqytet.



Akademik Qosja përkrah iniciativën që lulëkuqja me katër petale të jetë simbol i gjenocidit në Kosovë

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Akademik Rexhep Qosja përkrah iniciativën e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur", që lulëkuqja me katër petale të jetë simbol i gjenocidit në Kosovë.

Qosja ka shpërndarë në llogarinë e vet në "Facebook" vjeggzën e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur" në të cilën është parashtruar kërkesa drejtuar institucioneve të Kosovës që lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë. "Mbështetja nga akademik Rexhep Qosja, që lulëkuqja me katër petale të jetë simbol i gjenocidit në Kosovë, është lajm i veçantë në kontekstin e mbështetjeve plebishitare që ka hasur iniciativa e Qendrës 'Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur'. Të paçim edhe shumë dekada akademik Rexhep Qosja!", ka shkruar në "Facebook" kryetari i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur", Bardhyl Mahmuti.

"Pas konsultimeve të shumta, Qendra 'Gjenocidi në Kosovë - plagë e hapur' mbështeti idenë e Adnan Asllanit, që lulëkuqja të jetë simbol i viktimave të gjenocidit në Kosovë. Për dallim nga lulëkuqet që përdoren si simbol në shumë vende të tjera, katër petalet e lulëkuqes në logon e dizajnuar prej tij paraqesin katër format e akteve gjenocidare që Serbia zbatoi në Kosovë: vrasjen, dhunën seksuale, spastrimin etnik dhe shkatërrimin e objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar", është thënë në kërkesën e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur".

Përveç domethënies së veçantë që ka çdo petal i simbolit tonë dhe që e dallon nga forma e petaleve që kanë lulëkuqet-simbol të vendeve të tjera, në simbolin e gjenocidit në Kosovë dallon edhe "zemra e lulëkuqes": në vend të kokrrave të zeza të farës së lulëkuqes, në logon tonë



janë paraqitur figura burrash, grash, djemsh dhe vajzash, për t'i kujtuar njerëzit e të gjitha moshave dhe gjinive, që ishin

viktima të këtij gjenocidi. Lulëkuqja me katër petale është duke marrë përkrahje të madhe nga shkrimtarë, historianë,

përfaqësues të institucioneve qendrore e lokale, nga përfaqësues të medieve dhe nga shoqëria civile.

Bekim Jashari: Jemi të gatshëm si shtet, por edhe si shoqëri t'i dalim zot vendit tonë

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Ish-kryetari i komunës së Skenderajt, djali i heroit Hamëz Jashari, Bekim Jashari, ka reaguar në lidhje me situatën e fundit në veri. Jashari ka thënë se veprimet e fundit të shtetit tonë, policisë së shtetit, nuk duhet të shikohen e gjykohen ndryshe, pos si zbatim i detyrave të përcaktuara nga Kushtetuta jonë. "Republika e Kosovës si shtet i pavarur, është ndërtuar mbi parimet demokratike që sigurojnë liri dhe të drejta të plota për secilin qytetar të saj, pa dallim. Veprimet e fundit të shtetit tonë, policisë së shtetit nuk duhet të shikohen e gjykohen ndryshe pos si zbatim i detyrave të përcaktuara nga kushtetuta jonë e të njohura edhe me konventa ndërkombëtare. Shtrirja e sovranitetit shtetëror në çdo cep të territorit është obligim që duhet realizuar medoemos. Si shtet i ri, nga negociatat e shumta që kemi pasur kemi bërë kompromise të dhimbshme në emër të ruajtjes së paqes, stabilitetit rajonal dhe miqësisë ndërkombëtare", ka shkruar



Jashari në "Facebook".

Ai ka theksuar se me të drejtat që ua ka garantuar Kosova me Kushtetutë komuniteteve pakicë, kemi dhënë shembull në Evropë dhe botë sa i përket respektimit të

lirive dhe të drejtave në shkollim, punësim, pjesëmarrje në qeverisje etj. "Pra kemi dhënë aq shumë në luftë dhe në paqe, po ashtu edhe në tavolinë në negociata e bisedime dhe tani e

vetmja gjë që duhet bërë është ofrimi i sigurisë për banorët në veri dhe zhvillimi i kësaj pjese të vendit nëpërmjet punësimit dhe krijimit të perspektivës për të gjithë pa dallim. Njëkohësisht

Evropa dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë duhet të shohin politikën destruktive të Beogradit dhe të merren seriozisht me kërcënimet e Serbisë dhe atyre që ende jetojnë me iluzione e propaganda të Millosheviqit të cilat rrezikojnë stabilitetin e Ballkanit dhe me gjerë. Barrikatad në veri duhet të largohen menjëherë, qytetarët atje nuk duhet të vazhdojnë të mbahen peng nga politika e Beogradit. "Shtetin tonë nuk mund të kërcënojnë dhe as cenojnë askush nga Serbia. Ne jemi të gatshëm si shtet, por edhe si shoqëri, që t'i dalim zot vendit tonë, në jetësim të amanetit të heronjve, dëshmorëve e martirëve të lirisë. Në gjithë këtë rrugë, jetik mbetet unifikimi i spektrit politik në vend për ta përmbyllur këtë kapitull në koordinim të plotë me ShBA-në dhe shtetet e Evropës e botës demokratike. Krenar me policinë tonë që, pavarësisht prej rrethanave, qëndron në shërbim të shtetit dhe sigurisë së qytetarëve të Kosovës", ka shkruar Jashari.

Lajçaku viziton Prishtinën dhe Beogradin më 14 dhjetor

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Kryediplomati i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka konfirmuar se i dërguari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, më 14 dhjetor do t'i vizitojë Prishtinën dhe

Beogradin për të ndihmuar në uljen e tensioneve në veri të Kosovës. Sipas tij, BE-ja ka gatishmëri që të dërgojë përforsime për misionin e BE-së në Kosovë, EULEX. Borrell ka konfirmuar se situata

në veri të Kosovës ka qenë temë diskutimi në një takim të ministrave të Jashtëm të BE-së. Sipas njoftimit, të gjithë ata janë pajtuar se duhet "të merren hapa për uljen e tensioneve".



Mbi 2.8 milionë euro ndahen për kompensimin e dëmeve në bujqësi

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës të mbajtur të martën, ministrat të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Pecit, iu miratua propozim-vendimi për kompensimin e dëmeve në sektorin e bujqësisë, të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore siç janë: erërat e forta, breshëri, vërshimet, përmytjet dhe ngricat. Mbi 2.8 milionë euro është

shuma e mjeteve të ndara për kompensimin e dëmeve për bujqit vendorë të cilët pësuan nga fatkeqësitë natyrore në aktivitetin bujqësor të tyre. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të mbulojë 82 për qind të dëmeve në bujqësi për 22 komuna të vendit të cilat raportuan në Komisionin për shqyrtimin e raporteve për dëmet që u janë shkaktuar në komunën përkatëse.

Kompensim të dëmeve në vlerë totale prej 2.826.464,05 eurosh do të përfitojnë fermerët nga komuna e Deçanit, e Drenasit, e Ferizajt, e Gjakovës, e Gjilanit, e Istogut, e Junikut, e Kamenicës, e Leposaviqit, e Lipjanit, e Malishevës, e Mitrovicës, e Novobërdës, e Obiliqit, e Pejës, e Podujevës, e Prishtinës, e Rahovecit, e Shtëmës, e Skenderajt e Vitisë dhe komuna e Vushtrisë.



Ambasadori amerikan: Sektori privat luan rol të rëndësishëm në fuqizimin ekonomik

“Epoka e re”

Prishtinë, 13 dhjetor - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka marrë pjesë në Gala Darkën e Bamirësisë të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Hovenier ka falënderuar Odën Ekonomike Amerikane për mbledhje të fondeve për kauza të vlefshme. Ai ka thënë se ngjarjet si këto demonstron rëndësinë e përgjegjësisë sociale të korporatave. Ambasadori Hovenier ka thënë më tej se pjesëtarët e sektorit privat të Kosovës luajnë rol të rëndësishëm në adresimin e tri sfidave të ndryshme: diversifikimin e energjisë, fuqizimin ekonomik për të gjithë dhe sundimin e ligjit. Duke folur për diversifikimin e energjisë, ambasadori Hovenier ka theksuar se termocentralet e vjetra të Kosovës kanë ndikim të rëndësishëm në parashikueshmërinë e furnizimit me energji, në shëndetin e qytetarëve dhe në tërheqjen e investitorëve potencialë.

Ambasadori Hovenier ka theksuar rëndësinë e fuqizimit gjithëpërfshirës ekonomik, duke nënvizuar se 16 ditët e aktivizimit kundër dhunës gjinore. Hovenier ka theksuar se kur gratë gëzojnë mundësi të barabarta të garimit në biznes, atëherë ato performojnë shumë mirë. Ambasadori amerikan ka thënë se shoqëria përfiton nga



diversiteti më i madh në qeveri, institucionet shoqërore dhe komunitetet e biznesit. Ambasadori Hovenier ka kërkuar nga Oda Amerikane të luajë rol udhëheqës në shoqërinë e Kosovës për ta mundësuar eliminimin e barrierave në zhvillimin

profesional dhe heqjen e pengesave me bazë gjinore ndaj njerëzve ashtu që të gjithë të jemi kampionë të sigurimit të një mjedisi të barabartë. Ambasadori amerikan ka mirëpritur përpjekjet e Kosovës për luftimin e

korrupsionit, duke shtuar se Qeveria e ShBA-së është e përfshirë në përkrahjen e këtyre përpjekjeve, duke përfshirë edhe rolin aktiv të USAID-it në themelimin e gjykatës komerciale. Në fund ambasadori Hovenier ka falënderuar bizneset për

ndihmën në avancimin e vizionit të përbashkët për një Kosovë sovranë, të pavarur, të suksesshme dhe prosperuese, duke theksuar se ky është misioni i përbashkët i Ambasadës së ShBA-së dhe i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Haradinaj viziton AKB-në, njoftohet me sfidat që po përballen bizneset

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka vizituar të martën Aleancën Kosovare të Bizneseve (AKB), ku është prituri nga kryetari i saj, Agim Shahini. Ish-kryeministri Haradinaj është njoftuar për vështirësitë dhe sfidat me të cilat po përballen sot bizneset e vendit. “Fatkeqësisht, gjatë mandatit të kësaj qeverie roli i saj në zhvillimin ekonomik nuk është ndjerë

mjaftueshëm. Bizneset vendore po përballen me vështirësi të shumta të cilat po rrezikojnë funksionimin e tyre e shumë nga ato po përballen me rrezikun për mbijetesë. Bizneset prodhuese janë para kolapsit. Bizneset kanë rritje të kostos së prodhimit për shkak të rritjes enorme të çmimeve të lëndës së parë”, ka thënë Haradinaj. Ai ka theksuar se inflacioni i

shkaktuar nga rritja e çmimeve të energjisë dhe naftës, prodhuesit vendorë i ka sjellë në pozitë të pabarabartë në treg me prodhuesit konkurrentë nga vendet e tjera. “Bllokimi i investimeve publike e ka goditur rëndë ekonominë. Vonesa e Ligjit të Pagave ka sjellë varfërimin e një shtrese të popullsisë e, si pasojë, zvogëlimin e fuqisë blerëse në treg”, ka deklaruar Haradinaj.



Feniksat e lirisë

Ismet Bicaj – Inxhinieri i Energjisë Diellore që ra heroikisht për t'u bërë diell i Kosovës dhe Afrim Krasniqi – luftëtari nga Suedia që i fali jetën Kosovës



Shkruan: Astrit GASHI, Suedi

Sot e sa të jeta krenar me veprën tuaj!

E lëshuan Suedinë për t'i falën jetën Kosovës.

Fotot e tyre duhet të ishin në ambasadën tonë në secilin aktivitet. Këta janë ABC e secilit. Sa ta kem shpirtin vëllezër do t'ju kujtoj! Ju jeni kopertina më e bukur e secilit libër!

Mësues të dashur të mësimit plotësues në gjuhën shqipe ndani dy orë dhe tregojuni nxënësve për këta dy heronj të kombit.

Ismet Bicaj – Inxhinier i Energjisë Diellore që ra heroikisht për t'u bërë diell i Kosovës

Ismet Bicaj apo ndryshe i njohur me nofkën "Burim Guri" u lind në fshatin Vrellë në vitin 1958. Rrjedh nga një familje me tradita patriotike, shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, kurse shkollën e mesme e mbaroi në Pejë. Si shumë shqiptarë tjerë edhe Ismeti si i ri filloi ta ngre zërin kundër pushtetit të atëhershëm komunist. Në moshën 24-vjeçare

në vitin 1982 i ndjekur nga lakenjtë e politikës komuniste detyrohej ta lëshoj Kosovën. Ai vendoset në Suedi. Në Suedi e kreu edhe Fakultetin e Elektroteknikës – dega Energji Diellore. Kur thirri zëri i Kosovës Ismeti ishte i pari, e la gruan dhe fëmijët dhe mori rrugën për Kosovë. I pajisur me të gjitha mjetet luftarake që i duhen një luftëtari radhitet në mesin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në Haxhaj, fshat në Shqipëri takohet me ushtarët e parë të fshatit Vrellë: Verim Blakaj, Shasivar Haxhiaj, Ali Sefaj dhe Florim Demaj. Ky takim kishte dy gëzime, njëri ishte Betimi në Ushtrinë e parë Çlirimtare të Kosovës, kurse tjetri njohja me bashkëvendësit pas plot 17 viteve. Bashkë me këta ushtarë kalon kufirin Shqipëri-Kosovë dhe kthehet në vendlindje. Ardhja e Ismetit në Vrellë me uniformë të UÇK-së ishte një ditë e përjetuar ndonjëherë me parë, kjo ardhje nuk ishte e lehtë për të e as për fshatarët. Dikush duhet ta thyente akullin e parë formimin e celulave të para të UÇK-së. Këtë akull e theu Ismet Bicaj që vepronte në nofkën Burim Guri. Ishte nder kryesorët në formimin dhe stërvitjen e ushtarëve të Brigadës 133.

Me formimin e Brigadës 133 "Adrian Krasniqi" zgjidhet

ndihmës-komandant batalioni. Merr pjesë në vatrën e luftës në shumë vende të Kosovës si: Glllogjan, Likoc dhe Vrellë. Ra heroikisht, ballë për ballë me forcat serbo-çetnike më 12 prill 1999 në fshatin Vrellë. Trimat nuk vdesin kurrë. Fjalët e tij do të mbesin gjithmonë në kujtesën tonë si udhërrëfim për të ndërtuar një të ardhme ashtu siç e dëshirojmë dhe u flijua dëshmori i kombit Ismet Bicaj.

Afrim Krasniqi, luftëtari nga Suedia që i fali jetën Kosovës

Jetonte me familje në Rosengård të Suedisë, i cili ndryshe njihet edhe si kopshti i trëndafilave. Aty, Afrimi po jetonte së bashku me gruan Besën dhe dy vajzat e tija, Arjetën 6 vjeçe si dhe Saranden 3 vjeçe. Megjithatë as trëndafilat e Rosengård-it e as ngrohtësia e familjes së tij, nuk e ndaluan së shkuari në luftën për lirinë e Kosovës. Vendimin e kishte të prerë. 'Dua të shkoj të luftoj për lirinë e Kosovës. Aty kam prindërit, farefisën, miqtë. Aty është gjaku im. Aty është vendlindja, Tërpeza-Malisheva ime'. Suedinë e çmonte shumë, për mundësitë që i kishte ofruar, por pa Kosovën nuk jetonte

dot. Andaj, vendosi të niset së bashku me të gjithë djemtë e vashat që u nisën nga Suedia për të mbrojtur nderin dhe tokën e Kosovës.

U nis ballëllartë, ndonëse me dhimbje të madhe për familjen që po e linte vetëm. Në Kosovë, morri armët dhe iu bashkua radhëve të luftëtarëve të lirisë në frontin e luftës në Kosovë. Ishte njëri ndër luftëtarët Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Koshare, që po mbronin kufirin shqiptaro-shqiptar. Nga shokët e luftës, njihet si një nga luftëtarët më të aftë dhe me një taktikë të paparë. Luftonte me gjithë zemër, po aq sa e donte edhe lirinë e Kosovës.

Megjithatë, më 6 maj 1999 në kufirin shqiptaro-shqiptar, gjatë luftimeve të ashpra me armikun ai shkoi në altarën e lirisë, për të mos vdekur më kurrë. Për dikën mund të duket fat i keq, por për luftëtarët e lirisë 'rënia si dëshmorë në vijën e frontit, më konkretisht në Rrasën e Koshares, është nderi më i madh për një luftëtar'. Afrimi nuk kishte kursyer asgjë gjatë luftimeve të ashpra në këtë betejë, sepse donte ta shpërthente një herë e mirë kufirin i cili për aq shumë dekada kishte ndarë vëllezërit me vëllezër. Dhe vërtetë, Afrimi me shokë e thyen dhe e lanë me gjakun e qindra luftëtarëve të UÇK-së. Ai ia

fali jetën kombit, pikërisht aty ku ranë edhe shumë dëshmorë të tjerë si Luan Haradinaj e Mujë Krasniqi, Agim Ramadani, Sali Çeku, Xhemajl Fetahaj, Milazim Mavraj e qindra luftëtarë të tjerë.

Dhe sot pas kaq vitesh, më e pakta që ne mund të bëjmë është ta ripërtërijmë kujtimin për gjithë këta heronj të kombit. Më e pakta që ne mund të bëjmë është t'i vizitojmë familjen e Afrimit në qytetin e Kristianstadit, aty ku sot jeton gruaja me të bijat, trashëgimtarët e tij. Për gjithkënd familja është e shenjtë. Ashtu ishte edhe për Afrimin dhe gjithë dëshmorët e tjerë e patën të vështirë t'ia kthejnë shpinën familjes, por për ta kombi ishte mbi të gjitha dhe për të luftuan. Vepra e dëshmorëve na obligon jo vetëm ne por gjithë shoqërinë shqiptare, kudoqoftë ajo, të përkujdeset së paku moralisht për fëmijët dhe familjet e tyre.

E ku ka më të bukura se vargjet që një dëshmor i thur për fëmijët e tij. E vlen të lexohen disa rreshta të shkruara nga dëshmori i kombit Tahir Mal Sinani, për të kuptuar gjithë dashurinë që luftëtarët ndjejnë për fëmijët e tyre:

O njerëz mi ofroni,
O njerëz mi shikoni,
Siç ju desha unë,
Dua t'mi doni!!

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Argjentina me shkëlqim kualifikohet në finale të Botërorit

DOHA, 13 DHJETOR - Argjentina ka dhuruar spektakël e në fund e ka siguruar një biletë për në finalen e Botërorit, pasi e mposhti me rezultat 3-0 Kroacinë, rival ky që deri më sot u kishte hapur punë shumë skuadrave. Goli i parë do vinte prej futbollistit më të mirë në botë, Lionel Messi, i cili merr përsipër ekzekutimin e një penalltie dhe tregohet i saktë në minutën e 34-të. Kundërsulmi vrasës brenda pjesës së parë nga kombëtarja e "Albiceleste" përfundon me gol nga ylli i City, Alvarez. Në pjesën e dytë, gjërat do ishin akoma më të thjeshta, pasi sërish Alvarez do vuloste një herë e mirë fatet e këtij takimi pas një asistimi nga njeriu i magjishëm, Leo Messi. Në minutën e 74-të kishte minuta edhe për Dybala, ku lojtari i Romës debutoi në këtë

Kupë Bote në gjysmëfinale, pasi ka vuajtur një dëmtim. "Më kanë kaluar shumë gjëra në mendje, është shumë emocionuese. Të shohësh këta njerëz, familjen gjatë gjithë Botërorit... ishte diçka e pabesueshme, tani jemi aty ku dëshironim të ishim. Po i gëzohem shumë deri këtu ku kemi mbërritur, e nisëm duke humbur. I kërkuam njerëzve që të kishin besim te ne pasi e dinim. Ky grup është i çmendur, ia dolëm. Ndaj të gëzojmë gjithçka. Në këto momente kujtohem për familjen time, ky është maksimumi për mua, e kemi kaluar shumë keq dhe tani mund të përjetojmë diçka spektakolare", ka thënë Messi pas ndeshjes. Argjentina shkon kështu në finale, ku do presë fituesin nga ndeshja mes Francës dhe Maroku.



Maroku kërkon edhe një tjetër befasi në Botëror

"Epoka e re"

AL KHOR, 13 DHJETOR - Futbollistët e Kombëtares së Marokut kanë bërë befasinë më të madhe në Kupën e Botës pasi arritën deri në gjysmëfinale. Rrugës marokenët e mposhtën Spanjën e më pas Portugalinë, por një vlerë e madhe e kësaj kombëtare është se ka pranuar vetëm një gol deri tash. Maroku synon edhe befasinë e radhës ndaj Francës kur përballet sonte nga ora 20:00 në stadiumin "Al Bayt Stadium". Në anën tjetër, kampionia në fuqi e botës, Franca, synon finalen e dytë radhazi pasi e mposhti në çerekfinale Anglinë me rezultat 2-1. Për Francën shënuar Aurelien Tchouameni dhe Olivier Giroud, derisa për anglezët Harry Kane. Ky i fundit pati mundësi në fund të ndeshjes ta barazonte rezultatin, por dështoi nga penalltia. Trajneri Didier Deschamps në konferencë për shtyp theksoi se skuadra e tij do ta gjejë një mënyrë për t'i shënuar



Marokut që deri tani ka pësuar vetëm një gol. "Si t'i shënojmë Marokut? Do ta gjejmë një mënyrë. E di që ata kanë kapacitetin për t'u mbrojtur mirë dhe ky është një fakt që e kanë provuar në këtë Botëror. Objektivi ynë është t'i vëmë në vështirësi. Sa i takon skuadrës sime, ajo nuk më befason edhe pse për shumë

Formacionet e mundshme:

Franca: Lloris; Kounde, Varane, Upamecano, T. Hernandez; Tchouameni, Rabiot; Dembele, Griezmann, Mbappe; Giroud.
Maroku: Bono; Hakimi, El Yamiq, Aguerd, Mazraoui; Ounahi, Amrabat, Amallah; Ziyech, En-Nesyri, Boufal.

lojtarë është kompeticioni i parë madhor dhe nuk e dija si do të reagonin nga ana emocionale. Ne nuk ndryshojmë nga ndeshja në

ndeshje dhe synimi ynë është të jemi për pjesën më të madhe të kohës në zotërim të topit për të qenë të rrezikshëm dhe për të shënuar. Nuk mjafton vetëm kualiteti i futbollistëve dhe nuk ka një recetë për të bërë mrekullitë. Duhet t'i përshtatemi kundërshtarit për të fituar në fund", u shpreh Deschamps. Pavarësisht asaj se çka do të ndodhë në këtë ndeshje, Maroku është vendi i parë afrikan që arrin në gjysmëfinale të Kupës së Botës. Trajneri i Marokut, Walid Regragui, ka thënë se ëndërron që ta fitojë kundër Francës. Ai i ka paralajmëruar francezët që të ketë frikë nga përballja me marokenët. "Më pyetën nëse mund ta fitojmë Botërorin, iu përgjigja: Përse jo. Mund të ëndërroj, ëndrrat nuk kushtojnë asgjë. Ekipeve evropiane janë mësuar të fitojnë Botërore, por ne jemi përballur me ekipe të mëdha, në këto nivele, nuk kemi hasur vështirësi. E sigurt është se çdo skuadër që përballet me ne duhet të ketë frikë", ka thënë Regragui.

Shikohet mundësia e bashkëpunimit mes KOK-ut dhe KFOR-it italian

Prishtinë, 13 dhjetor - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka pritur në takim përfaqësuesit e KFOR-it italian, të cilit i printe udhëheqësi Alfredo Gargiuoli. Presidenti Krasniqi, që shoqërohej nga koordinatori arsimor në Akademinë

Olimpikë, Fitim Arifi, falënderoi mysafirët për vizitën dhe kontributin që po e japin për ruajtjen e paqes në Kosovë. Krasniqi i njoftoi me aktivitetet e Komitetit Olimpik të Kosovës si dhe sukseset e arritura në arenën ndërkombëtare, me theks të veçantë tri medaljet e

arta olimpikë. Nga ana e tij, udhëheqësi i KFOR-it, Gargiuoli, falënderoi presidentin Krasniqi për pritjen si dhe e përgëzoi për punën dhe sukseset e arritura. Të dyja palët biseduan për mundësi të bashkëpunimit në aktivitete të ndryshme.



Inzaghi për Ronaldon: E kemi të vështirë ta pranojmë fundin e karrierës sonë

REGINA, 13 DHJETOR - Filippo Inzaghi, ish-sulmuesi i famshëm italian për instinktin "vrasës" brenda zonës, deklaroi se e kupton momentin që po kalon Cristiano Ronaldo, duke iu referuar ngjarjeve të fundit

dhe reagimit të "yllit" portugez, sidomos pas eliminimit të Portugalisë. "Për ne është gjithmonë e vështirë ta pranojmë fundin e karrierës sonë. Asnjëherë nuk e di se çfarë të pret më pas, sepse ajo që bën të jep

ndjenja që është e vështirë t'i rikuperosh", ka thënë Pipo. Trajneri aktual i Regginas në Serinë B italiane argumenton se për çdo trajner është e vështirë të menaxhojë situata si ajo e portugezit. "Askush nuk e di se çfarë po kalon në

kokën e tij, por nuk është e lehtë për një trajner të përballet me një situatë si kjo. Për fatin tim, më detyruan të ndalem, por disa lojtarë e meritojnë ta përfundojnë karrierën në një nivel të lartë", ka shtuar Inzaghi.



Ronaldo: Neymari është i rëndësishëm për Brazilin, shpresoj të luajë në Botërorin e ardhshëm

DOHA, 13 DHJETOR - Ronaldo "fenomeni" ishte i pranishëm në një konferencë për shtyp, të zhvilluar në Doha të Katarit, ku foli edhe për fantazistin e Brazilit, Neymar. Ronaldo u shpreh tepër i lumtur për përkushtimin e Neymarit ndaj kombëtares braziliane, ku bëri më të mirën e tij, për t'u rikuperuar nga ai dëmtim në kavilje gjatë ndeshjes me Serbinë. "Mendoj se për momentin ai është i zemëruar për eliminimin e tij. Është normale që ai të ndihet kështu, por jam i sigurt se do të kthehet më i fortë dhe do të vazhdojë të luajë për ekipin. Ai është ende i ri, është 31 vjeç dhe mendoj se mund të luajë në Botërorin e ardhshëm", ka thënë Ronaldo. "Jam shumë i lumtur që i ka rreguar Botës përkushtimin e tij



ndaj kombëtares dhe se është kujdesur për veten në gjashtë muajt e fundit. Ai ka qenë i mirë në ndeshjen e parë, më pas e zgjidhi problemin me kyçin e këmbës dhe bëri sakrificë të mëdha për të qenë në gjendje të luajë përsëri. Ai

gjithashtu pati një lojë të shkëlqyer kundër Kroacisë. Është shumë i rëndësishëm për ne, kështu që shpresoj që të shërohet shpejt dhe të rikthehem më të fortë me PSG-në dhe kombëtaren", ka deklaruar Ronaldo.

Brooklyni tregon dhëmbët, Bostoni sërish gabon

WASHINGTON, 13 DHJETOR - Humbja e dytë radhazi për ekipin e Bostonit, që u mund me rezultat 113-93 nga Clippersat, por që ruan kreun e renditjes në Lindje. Ndeshje e dominuar nga kalifornianët, ku u dalluan George me 26 pikë e Leonard me 25 pikë. Jashtë fushës ka fituar ekipi i Miamit, që mundi me rezultat 87-82 Indianan. Tjetër ndeshje e mirë për Adebayo, që realizoi 22 pikë e 17 rebounde, mbështetur edhe nga Butleru me 20 pikë. Dallasi, falë 38 pikëve e 11 reboundeve të Luka Donçiqit, mundi pa problem Oklahomën me rezultat 121-114. Fitore në sekondën e fundit për San



Antonion, që mposhti Clevelandin, në një sfidë ku stoli i Spursit bëri diferencën, duke realizuar 55 pikë. Fitorja e katërt radhazi për Brooklynin, që duket se po kalon

një formë të mirë. Netsi mundi me rezultat 112-100 Washingtonin, me Durantin protagonist, autor i 30 pikëve, mbështetur edhe nga Irvingu me 24 pikë.

REZULTATET

Indiana - Miami	82-87
Washington - Brooklyn	100-112
Memphis - Atlanta	128-103
Dallas - Oklahoma	121-114
San Antonio - Cleveland	112-111
Portland - Minnesota	133-12
Clippers - Boston	113-93

Leclerc: Nuk më kënaq pozita

Piloti Charles Leclerc nuk është i kënaqur që përfundoi në pozitën e dytë në kampionatin 2022. Piloti i Ferrarit në Formula 1

përfundoi i dyti, kurse në pozitën e parë ishte Max Verstappen dhe Sergio Perez në vend të tretë. "Jo shumë kënaqësi, për të qenë i

sinqertë. Duke parë pas sezonit, mendoj se ka qenë një sezon i mirë, veçanërisht duke parë 2020 dhe 2021 që kanë qenë dy vite shumë të vështira

për ekipin", ka thënë Leclerc. "Ndjenjë të përziera për këtë sezon, por vendi i dytë është mjaft i mirë. Thjesht shpresoj se është një hap përpara dhe

se për vitin e ardhshëm ne mund të bëjmë një hap tjetër përpara", ka shtuar Leclerc, i cili grumbulloi 308 pikë, me tri pikë dhe 11 podiume.

SHKURT

Berisha bisedon me Salernitanën

Etrit Berisha pritet të largohet nga Torino pas një viti e gjysmë qëndrim në këtë skuadër. Portieri shqiptar nuk është titullar dhe këtë edicion nuk është paraqitur në asnjë ndeshje. Kjo ka bërë që prishtinasi të mendojë largimin gjatë janarit dhe tanimë ka nisur bisedimet me një klub tjetër elitare në Serinë A. Sipas asaj që ka raportuar mediumi italian "TuttomercatoWeb", Berisha ka nisur kontaktet me Salernitanën, klub tjetër që bën gara në Serinë A. Klubi italian pritet që të kërkojë huazimin e Berishës nga Torino me të drejtë blerje. 33-vjeçari ka 10 vjet në futbollin italian, derisa më herët ka mbrojtur edhe për Lazio, Atalantën e SPAL-in.

Vdes gazetari i tretë gjatë Kampionatit Botëror 'Qatar 2022'

Është konfirmuar se ka vdekur edhe gazetari i tretë gjatë Kampionatit Botëror "Qatar 2022". Bëhet fjalë për Roger Pearce, drejtor teknik i kanalit televiziv anglez "ITV Sport". 65-vjeçari i cili raportohet se ka vdekur me datën 21 nëntor, para fillimit të ndeshjes ShBA-Uells. Kjo u konfirmua edhe nga gazetari i BBC-së, Nail Stainsby, i cili ishte edhe miku i Roger Pearce. Stainsby ka thënë se Pearce do të tërhiqej nga angazhimi i tij pas pesë javësh. Gazetari anglez është gazetari i tretë që ka vdekur pas gazetarit amerikan Grant Wahl dhe fotoreporterit Khalid al-Misslam.

Santosi largohet nga Portugalia

Fernando Santos nuk do të jetë më trajner i Portugalisë. Mediet portugeze raportojnë se Santos ka arritur marrëveshje me Federatën e Futbollit të Portugalisë për shkëputjen e kontratës, e cila i skadon në verën e vitit 2024. Santos është kritikuar për vendimet e tij në Kupën e Botës pasi kishte vendosur ta lë në stol Cristiano Ronaldon në dy ndeshjet e fundit. Portugalia u eliminua në çerekfinale nga Maroku pasi u mposht me rezultat 1-0 në çerekfinale. Nën drejtimin e Santos, Portugalia është shpallur kampione e Evropës dhe ka triumfuar në Ligën e Kombeve.

Chelsea nuk e lejon largimin e Jorginhos

Mesfushori i Italisë, Jorginho, është synim i dy skuadrave angleze, Tottenham Hotspur dhe Arsenal. Mirëpo, Chelsea nuk është e interesuar ta lejojë largimin e njërit prej lojtarëve më të mirë që ka aktualisht. Gazetari italian Matteo Moretto ka raportuar se Chelsea ka në plan një takim me Jorginhon para Krishtlindjeve për ta diskutuar të ardhmen e tij dhe t'i ofrojë atij një marrëveshje të re.



ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1909

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
0.5L